



“Mbështetje për Rrjetin e Prokurorëve në Europën JugLindore” Projekti Rajonal PROSECO

– përmbledhje e projektit –

Titulli i projektit	Plani Rajonal i Veprimit i CARDS Mbështetje për Rrjetin e Prokurorëve (Projekti Rajonal PROSECO)
Zonat e përfshira në projekt	Evropa Jug-Lindore: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, dhe UNMIK-Kosovë
Buxheti	1,666,669.20 Euro
Financimi	Komisioni Evropian (90%) – Këshilli i Europës (10%)
Zbatimi	Këshilli i Europës (Divizioni i Krimit Ekonomik, Drejtoria e Bashkëpunimit, DG për Të Drejtat e Njeriut dhe Çështjet Ligjore) dhe Ministria e Drejtësisë së Italisë
Kohëzgjatja	24 muaj (Pril 2008 – prill 2010)

SFONDI DHE JUSTIFIKIMI

Nevoja për të marrë masa kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe formave të tjera të krimeve të rënda, të cilat përbëjnë pengesë për stabilitetin demokratik, shtetin e së drejtës dhe zhvillimin ekonomik e social në Evropën Juglindore, është vënë në dukje nga Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian (KE) dhe organizata të tjera në raste të ndryshme (psh: raportet e SAP dhe dokumentet strategjike). Duke pasur parasysh natyrën ndërkombëtare të fenomeneve të krimit të organizuar dhe korrupsionit, është e qartë se të gjitha përpjekjet për t'i trajtuar ato me sukses kërkojnë forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe një qasje e metodologji të përbashkët për mënyrat e luftës kundër tyre.

Megjithëse janë ndërmarrë shumë projekte dhe nisma në mbështetje të vendeve të Evropës Jug-Lindore për të trajtuar aspekte që lidhen me luftën kundër krimeve të rënda, ka ende vend për përmirësim të mëtejshëm, veçanërisht në fushën e bashkëpunimit rajonal.

Në 17 nëntor 2006, Forumi i përvitshëm Ministror BE-Ballkan Perëndimor mbi Çështjet e Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme (JHA), i mbajtur për herë të parë në Evropën Jug-Lindore (Tiranë, Shqipëri) theksonte se *“natyra rajonale e problemeve që lidhen përgjithësisht (...) me fenomenin e krimit të organizuar kërkon një përgjigje rajonale. Takimi nënvizoi rëndësinë që kishte adoptimi i një qasje rajonale bashkëpunuese ndaj problemeve (...)”*.

Nga ky këndvështrim, Memorandumi i Mirëkuptimit (MU) mbi Bashkëpunimin Rajonal dhe Ndërtimin e Rrjeteve të Prokurorëve, i firmosur nga vendet e CARDS në 30 Mars 2005 në Shkup, përfaqëson një pikënisje të rëndësishme.

Ndërgjegjësimi në rritje për domosdoshmërinë e një qëndrimi rajonal ndaj krimit të organizuar shihet edhe në përfundimet e takimit të katërt të Rrjetit të Prokurorëve, mbajtur në Sarajevë në 5 dhe 6 Mars 2007.

OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITSHME

Objektivi kryesor i projektit është qw nwpërmjet mbështetjes së Rrjetit të Prokurorëve, tw arrihet fuqizimi i kapaciteteve të vendeve të përfshira në programin CARDS për të zhvilluar dhe zbatuar bashkëpunimin në luftën kundër krimeve të rënda, bazuar në *acquis e BE-sw* dhe standarte dhe praktika të tjera Evropiane e ndërkombëtare.

Projekti do të përqëndrohet veçanërisht në forcimin e kapaciteteve ligjore dhe institucionale të Zyrave të Prokurorëve të Përgjithshëm (ZPP) të vendeve të Evropës Jug-Lindore, me qëllim arritjen e një bashkëpunimi më efektiv në luftë kundër krimeve të rënda. Projekti do të zhvillojë më tej rezultatet e arritura nga Projekti CARDS 2003 "Për Reformën Rajonale në Drejtësi" (duke vënë theks të veçantë tek aktivitetet ndër-modulare të zbatuara prej tij) si dhe elementët thelbësorë për bashkëpunim të ardhshëm të parashikuara në Memorandumin e Bashkëpunimit, nënshkruar më 30 mars 2003 nga Prokurorët e Përgjithshëm të vendeve të CARDS.

Për të arritur objektivin e tij, projekti do të zbatojw aktivitete si brenda vendeve, ashtu edhe nw nivel rajonal, të ndara në katër rezultate:

Rezultat	Aktivitete
I pwr gjithshww m	Faza e fillimit/Nisja e projektit
Aktivitet1	Aktivitetet e fillimit, takime, seminare me partnerët
Aktivitet 2	Përgatitja e një raporti fillestar dhe e një plani pune të detajuar
Aktivitet 3	Organizimi i konferencës së prezantimit në Romë, Itali
Rezultat1	Projektligje që kanë si qëllim hetim dhe ndjekje penale të suksesshme të rasteve të krimeve të rënda dhe lehtësimin e bashkëpunimit rajonal
Aktivitet 1.1	Kryerja e njw vlerwsimi me qëllim identifikimin e ligjeve që duhen rishikuar dhe përmirësuar (nëpërmjet vizitave në secilin prej vendeve të projektit gjatë fazës së fillimit)
Aktivitet 1.2	Deri në 2 rishikime ligjore për secilën zonë të projektit dhe (konsulencë të vazhdueshme ad hoc) me qëllim rishikimin e ligjeve ekzistuese mbi hetimin, ndjekjen penale dhe bashkëpunimin në luftë kundër krimeve të rënda: Kodin e Procedurës Penale, Ligjin mbi Policinë, Ligjin mbi Prokurorinë, Ligjin mbi Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe ligje të tjera që lidhen me to. Legjislacioni duhet rishikuar për t'u përafuar me instrumentet Evropiane dhe ndërkombëtarë.
Aktivitet 1.3	2 tryeza të rrumbullakwta për secilën zonë të projektit (në vijim tw rishikimeve ligjore) si dhe dy seminare rajonale
Rezultat 2	Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore të shërbimeve të prokurorisë me qëllim arritjen e një bashkëpunimi, hetim dhe ndjekje penale më efektive të rasteve të krimeve të rënda
Aktiviteti 2.1	4 trajnime tematike në nivel rajonal, mbi ekipet e përbashkëta hetimore, përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit, krimin nëpërmjet internetit, mbrojtjen e dëshmitarit, konfiskimin dhe ndarjen e aseteve.

Aktiviteti 2.2	2 trajnime brenda vendit mbi tema të cilat paraqesin interes parësor për çdo vend pjesëmarrës në projekt.
Aktiviteti 2.3	Organizimi i programeve 2 javore të praktikës (3 prokurorë për çdo vend pjesëmarrës në projekt) në vende anëtare të BE-së (Itali, Portugali dhe Slloveni)
Rezultat 3	Udhëzues mbi Bashkëpunimin dhe mjetet e tjera në dispozicion për një bashkëpunim më efektiv në fushën e krimeve të rënda
Aktiviteti 3.1	Përkthimi i raporteve shpjeguese të konventave dhe dokumenteve të tjera me interes parësor dhe publikimi i tyre në gjuhët lokale të vendeve të përfshira në projekt
Activity 3.2	Përditësimi dhe publikimi i udhëzuesit të PACO-s mbi bashkëpunimin rajonal në fushën e drejtësisë për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
Activity 3.3	Ndërtimi i faqeve të internetit mbi bashkëpunimin në fushën e drejtësisë, të cilat do të jenë pjesë e faqeve ekzistuese të zyrave të Prokurorisë dhe/ose Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Rendit/Brendshme.
Rezultat 4	Pikat e kontaktit për bashkëpunimin e përmirësuar në drejtësi
Aktivitet 4.1	Vlerësim i rrjeteve ekzistuese të bashkëpunimit, pikave të kontaktit dhe kuadrit ligjor që bën të mundur funksionimin e tyre.
Aktivitet 4.2	Organizimi i 2 takimeve rajonale me qëllim rishikimin e kompetencave të pikave të kontaktit dhe burimeve të disponueshme me qëllim përmirësimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të tyre.
Aktivitet 4.3	Organizimi i 2 takimeve rajonale të pikave të kontaktit, anëtarëve të rrjeteve të prokurorëve dhe krerëve të njësive të luftës kundër krimit të organizuar nga çdo vend i projektit për të përmirësuar rrjetet në nivel rajonal.
Aktivitet 4.4	Organizimi i një konference rajonale të rrjeteve të prokurorëve me qëllim përmirësimin e Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Ngritjen e Rrjetit të Prokurorëve

Grupet e synuara:

- Prokurorët dhe gjyqtarët e specializuar në luftën kundër krimit të organizuar;
- Zbatuesit dhe zyrtarët e lartë nga Ministria e Drejtësisë (MD);
- Zbatuesit dhe zyrtarët e lartë të Ministrisë së Rendit/ Brendshme

Përveç këtyre, tek përfutjesit do të përfshihen edhe zbatues e institucione të tjera të cilët kryejnë aktivitete që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar (p.sh: Ministrinë e Punëve të Jashtme, NCB, Interpol) si dhe institucionet e kualifikimit në fushën e drejtësisë në secilin vend pjesëmarrës në projekt.

RREGULLIMET E MËNYRËS SË ZBATIMIT

Këshilli i Evropës, Divizioni i Krimit Ekonomik, Departamenti i Bashkëpunimit, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Çështjeve Ligjore) është përgjegjëse për menaxhimin në tërësi të projektit, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë Italiane të Drejtësisë.

Zyrat e Prokurorëve të Përgjithshëm janë një nga dy institucionet kryesore partnere në projekt, përgjegjëse për të siguruar mbështetjen e duhur për zbatimin pa pengesa të projektit nga ana e drejtuesve të tij. Në çdo vend pjesëmarrës, Prokurori i Përgjithshëm do

të caktojë nga një prokuror, i cili do të shërbejë si pikë kontakti gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Ministritë e Drejtësisë janë institucioni i dytë, partner në projekt, dhe kanë si detyrë të mbështesin njësinë e manaxhimit të projektit për të siguruar një zbatim pa pengesa të këtij të fundit. Në secilin vend pjesëmarrës, MD do të caktojë një zyrtar si person kontakti për gjithë kohëzgjatjen e projektit.

Do të ngrihet një Komitet Drejtues, i cili do të ketë si detyrë këshillimin teknik dhe strategjik, si dhe mbikqyrjen e zbatimit të projektit. Ky komitet do të mblidhet në fillim të projektit, dhe më pas çdo 6 muaj.

Komiteti Drejtues do të përbëhet nga një përfaqësues i ZPP dhe MD për secilin vend pjesëmarrës. (pra, 2 anëtarë nga secili vend pjesëmarrës) Njëkohësisht në Komitet do të përfaqësohet Këshilli i Evropës dhe partneri i tij (Ministria Italiane e Drejtësisë) si edhe KE. (nga një përfaqësues për secilin prej tyre).

KONTAKTE

Për informacion të mëtejshëm, ju lutem kontaktoni me :

Divizioni i Kriminologjik, Departamenti i Bashkëpunimit, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Çështjeve Ligjore)

F-67075 Strasbourg Cedex (France)

☎ + 33 3 9021 4646 Fax + 33 3 9021 5650 ✉:vesna.efendic@coe.int

Ministria Drejtësisë së Italisë

☎ + 39 06 6885 2906 Fax + 39 06 6889 7948 ✉: marco.mancini@giustizia.it